



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 394/3 Prot

Tiranë, më 17 . 3 .2022

VENDIM

Nr. 05 , datë 17 . 3 .2022

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) Formularin e Ankesës nr. 394 Prot., datë 16.02.2022, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik “Agjencia e Zhvillimit të Territorit” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuesit nëpërmjet e-mail-it datë 13.01.2022, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni lidhur me shoqërinë koncensionare Porti MBM (Multi Buoy Mooring), që operon në Porto - Romano Durrës, si më poshtë:

1. *Një kopje të Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 6, datë 11.10.2016: Për miratimin e lejes së zhvillimit për ndërtimin e Porti MBM, me vendndodhje në Porto Romano, Bashkia Durrës.*
2. *Një kopje të projektit të paraqitur dhe miratuar nga ana juaj dhe dokumenteve bashkëshoqëruese;*
3. *Një kopje të Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 27 dt. 26.07.2018: Miratimin e ndryshimeve të projektit gjatë ndërtimit për objektin “Porti MBM”, me vendndodhje në Porto Romano, Bashkia Durrës.*
4. *Një kopje të projektit të paraqitur dhe miratuar nga ana juaj dhe dokumenteve bashkëshoqëruese.*

Në mungesë të një përgjigje nga Autoriteti Publik, ankuesi, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ka paraqitur ankim pranë Zyrës së Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit” (në vijim LDI).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”*, Komisioneri, me shkresën nr. 394/1 prot., datë 18.02.2022 ka kërkuar nga Autoriteti Publik sqarime në lidhje me disponimin e dokumentacionit të kërkuar, duke vlerësuar kërkesën për informacion, brenda datës 25.02.2022.

Koordinatori për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik, me e-mail-in datë 28.02.2022, ka sqaruar se: *“Këshilli Kombëtar i Territorit në mbledhjen e datës 11.10.201, ka marrë Vendimin Nr. 6, “Për miratimin e Lejes së Zhvillimi për objektin: “Ndërtimi i Portit MBM”, me vendndodhje në Porto Romano, Bashkia Durrës, me subjekt zhvillues shoqërinë koncesionare “Porti MBM” sh.p.k.”, në përputhje me Ligjin Nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Gjithashtu, Këshilli Kombëtar i Territorit në mbledhjen e datës 26.07.2018, ka marrë Vendimin Nr. 27, “Për miratimin e Ndryshimit të projekti gjatë ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i Portit MBM, me vendndodhje në Porto Romano, Bashkia Durrës”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Porti MBM” sh.p.k. Ndërkohë, referuar Ligjit Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të cilit i referoheni në shkresën Tuaj, sqarojmë se: Sipas Nenit 17 “Kufizime”, pika 1, shkronja “c”, të Ligjit në fjalë, e drejta për informim kufizohet kur dëmton të drejtën e autorit. Për sa më sipër, duke qenë se titullari i kësaj të drejte nuk ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës, ashtu sikurse përcaktohet në ligjin e sipërpërmendur, Agjencia e Zhvillimit të Territorit nuk mund t’ju vendos në dispozicion dokumentacionin tjetër të kërkuar, pasi mbështetur në Nenin 8 “Veprat”, pika 1, shkronjat “e” dhe “g”, të Ligjit Nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, veprat që janë objekt i mbrojtjes së të drejtës së autorit janë: e) krijimet arkitekturore, që përfshijnë vizatimet, planet, skicat në shkallë të zvogëluar dhe krijimet grafike në projektet arkitekturore; g) krijimet tredimensionale, ilustrimet, listat, hartat dhe vizatimet në fushën e topografisë, gjeografisë dhe shkencës në përgjithësi. Ndërkohë, në përmbushje të kërkesës suaj, lutemi gjeni bashkëngjitur kopje të dokumenteve të listuara si më poshtë vijon, ku evidentohen në mënyrë të detajuar informacione përshtues dhe grafike, mbi kushtet e zhvillimit për objektin në fjalë, sikurse mund të përmendim: pasuritë e përfshira në projektin e miratuar,*

sipërfaqen e përgjithshme të truallit, sipërfaqen e përgjithshme të ndërtimit, numri i kateve mbi/nën tokë, etj., të dhëna nëpërmjet të cilave mund të informoheni mbi treguesit teknikë të projektit të miratuar.

- Vendimi Nr. 6, datë 11.10.2016 i KKT-së, "Për miratimin e Lejes së Zhvillimi për objektin: "Ndërtimi i Portit MBM", me vendndodhje në Porto Romano, Bashkia Durrës, me subjekt zhvillues shoqërinë koncesionare "Porti MBM" sh.p.k."
- Harta e Planvendosjes së strukturave për miratimin e Lejes së Zhvillimit për objektin: "Ndërtimi i Portit MBM", me vendndodhje në Porto Romano, Bashkia Durrës.
- Vendimi Nr. 27, datë 26.07.2018 i KKT-së, për miratimin e Ndryshimit të projekti gjatë ndërtimit për objektin: "Ndërtimi i Portit MBM, me vendndodhje në Porto Romano, Bashkia Durrës", me subjekt zhvillues shoqërinë "Porti MBM" sh.p.k.
- Harta e Planvendosjes së strukturave, për miratimin e Ndryshimit të projekti gjatë ndërtimit për objektin: "Ndërtimi i Portit MBM, me vendndodhje në Porto Romano, Bashkia Durrës", me subjekt zhvillues shoqërinë "Porti MBM" sh.p.k.

Së fundi, dokumentacionin e sipërcituar mund ta aksesoni edhe në faqen zyrtare [ëëë.azht.gov.al](http://eëë.azht.gov.al)."

Pas përgjigjes së dhënë nga Autoriteti Publik, ankuesi pretendon se nuk i është vënë në dispozicion informacioni i kërkuar në pikën 2 dhe 4 të kërkesës për informacion datë 13.01.2022 dhe si rrjedhojë me emailin e datës 07.03.2022, regjistruar me nr. 394/2 Prot., datë 07.03.2022 ka vijuar ankimin pranë Komisionerit, duke kërkuar plotësimin e dokumentacionit të kërkuar.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se, arsyetimi i Autoritetit Publik për refuzimin e vënies në dispozicion të dokumentit të kërkuar me argumentin se një gjë e tillë kufizohet nga e drejta për informim sipas nenit 17, pika 1 gërma c) e LDI, si dhe nga dispozitat e ligjit nr. 35/2016, "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", nuk qëndron.

Neni 17, pika 1 gërma c) e LDI parashikon se: "E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm: ... c) të drejtën e autorit". Ndërkohë, në vijim neni 17, parashikon ndër të tjera se: "...Pavarësisht nga sa parashikohet në këtë pikë, informacioni i kërkuar nuk refuzohet në rast se ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij".

Projektet e paraqitura dhe miratuar nga ana e Autoritetit Publik, së bashku me dokumentet bashkë-shoqëruese sa i përket miratimit të lejes së zhvillimit për ndërtimin e Porti MBM dhe miratimit të ndryshimeve të projektit gjatë ndërtimit për objektin "Porti MBM" me vendndodhje në Porto Romano, Bashkia Durrës, përbëjnë në vetvete pjesë përbërëse të Kontratës së Konkensionit të formës "BOT" (Ndërtim, Shfrytëzim dhe Transferim) të një porti të llojit MBM në Porto Romano, Durrës, miratuar me ligjin nr. 104/2015, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Shoqërisë Konkensionare Porti MBM (Multy Buoy Mooring), i ndryshuar.

Komisioneri ka konsoliduar qëndrimin e tij lidhur me kontratat e koncensioneve publike, si dhe dokumentacionin pjesë përbërëse të tyre, duke i konsideruar ato informacion publik për sa kohë që nuk ka parashikim të pasaçëm ligjor të ndryshëm nga parashikimet e LDI. Referuar kontratës së miratuar me ligjin nr. 104/2015, i ndyshuar, Autoriteti Publik nuk paraqiti ndonjë dispozitë të posaçme të këtij ligji, sipas së cilës të drejtat e autorit do të përbëjnë shkak për kufizimin e të drejtës për informim sipas LDI.

Po ashtu, Autoriteti Publik nuk paraqiti asnjë provë lidhur me pretendimin e ekzistencës së të drejtave të mbrojtura të autorit në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”. Megjithatë, edhe nëse do të provohej ekzistenca e të drejtave të mbrojtura të autorit mbi informacionin/dokumentacionin e kërkuar, në bazë të nenit 78 të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, *“Veprat me të drejtë autori do të lejohen të riprodhohen dhe të përcillen për publikun, për rastet konkrete, pa autorizimin e autorit ose të titullarit të së drejtës së autorit dhe pa shpërblim, për kryerjen e detyrave që lidhen me sigurinë publike, për përdorimin dhe kryerjen e procedurave gjyqësore, administrative, parlamentare dhe procedurave në arbitrazh, përveçse në rastin e përmbledhjeve”*. Në këtë kuptim, veprat me të drejtë autori do të lejohen të riprodhohen dhe të përcillen për publikun, për rastet konkrete, pa autorizimin e autorit ose të titullarit të së drejtës së autorit dhe pa shpërblim, për përdorimin dhe kryerjen e procedurave administrative si në rastin konkret. Nga ana tjetër, në parim kërkesa e ankuesit për t’u informuar nuk cënon apo zhvesh autorin nga të drejtat e njohura me ligjin e posaçëm, si dhe mekanizmat që ky ligj i vë në dispozicion autorit dhe/ose mbajtësit të së drejtës për të mbrojtur apo gëzuar atë.

Pavarësisht sa më sipër, në cdo rast, Autoriteti Publik duhet të kishte argumentuar moszbatimin e parashikimit në paragrafin e fundit të pikës 1 të nenit 17 të LDI, sipas të cilit informacioni i kërkuar nuk refuzohet në rast se ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij. Duke qenë se informacioni i kërkuar lidhet me një kontratë koncension, objekti i së cilës është ndërtimi i një vepre publike dhe/ose shërbimi publik, interesi publik në marrjen e informacionit në këtë rast është i drejtëpërdrejtë dhe i lartë dhe si rrjedhojë, ky dokumentacion i cili disponohet në kuadër të veprimtarisë institucionale të Autoritetit Publik, duhet të ishte bërë publik duke garantuar kështu njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Si përfundim, Komisioneri vlerëson se, dokumentacioni i kërkuar përmbush në parim kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të LDI sipas të cilit: *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik*”. Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse është prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar në formën e zotëruar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të këtij ligji, sipas të cilit: *“Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e*

dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike. Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e LDI parashikon se: “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

Theksojmë, se e drejta për t’u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, lidhur me pikat 2 dhe 4 të ankesës së _____ kundër Autoritetit Publik, Komisioneri vlerëson se duke pasur parasysh sa është parashtruar më sipër, ankimi është i drejtë dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin pjesërisht të ankesës nr. 394 Prot., datë 16.02.2022, të _____ kundër Autoritetit Publik “Agjencia e Zhvillimit të Territorit”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar në pikat 2 dhe 4 të kërkesës për informacion datë 13.01.2022, konkretisht: (“1. Një kopje të projektit të paraqitur dhe miratuar nga ana juaj dhe dokumenteve bashkëshoqëruese; 2. Një kopje të projektit të paraqitur dhe miratuar nga ana juaj dhe dokumenteve bashkëshoqëruese”), brenda datës 25. 3.2022.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 17. 3.2022.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

